



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 138 Akti

Nr. 98 Vendimi

Tiranë, më 11.01.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Peter Kijlstra, në Tiranë, më datë 10 janar 2019, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Adrian Shega, me detyrë (ish) këshilltar pranë Gjykatës së Lartë, - pa përfaqësues.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, z. Adrian Shega, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 10.01.2019, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Adrian Shega, ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë nga data 03.02.2014 deri më datë 31.07.2017¹.
- ii. Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 kishte hyrë në fuqi, ai ka qenë në pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe brenda datës 31.01.2017 ka dorëzuar pranë ILDKPKI – së, DSIK-së dhe KLD-së dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “*Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio*”. Në këto kushte ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Adrian Shega.
- iv. Më datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. (***) prot., vë në dijeni Komisionin e Pavarur të Kualifikimit se subjektet e rivlerësimit *ex officio* midis të cilëve edhe z. Adrian Shega në ditën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës dhe fillimit të programit mësimor, më datë 1 tetor 2018, janë të detyruar sipas ligjit të ndërpresin marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionet ku punojnë, për të frekuentuar rregullisht programin dhe të respektojnë Rregulloren e shkollës.
- v. Sipas pikës 1, të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “*Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe*

¹ Referojuni dokumenteve bashkëngjitur shkresës nr. (***)prot., datë 18.09.2018, të Gjykatës së Lartë në dosjen e Komisionit.

në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- vi. Sipas pikës 8, të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: *“Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të këtij neni, nuk kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, marrëdhënia e punës së tyre mbaron në datën e fillimit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në zbatim të ligjit, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Injēti rregull zbatohet edhe për ata, të cilët nuk kanë përfunduar ende procesin e rivlerësimit, por kanë kaluar me sukses testimin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në rast se institucioni për rivlerësimin merr vendim për masën e shkarkimit, ndërpritet ndjekja e programit të trajnimit dhe subjekti përjashtohet nga programi i trajnimit”.*
- vii. Për sa më sipër, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, çmoi të vazhdojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Adrian Shega.
- viii. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim si Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15 maj 2018 nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët, e sipërcituar.
- ix. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 4, pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 24 maj 2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, znj. Genta Tafa (Bungo). Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- x. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e z. Adrian Shega, më datë 3 janar 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet, dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për, z. Adrian Shega, të bazohet në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- xi. Më datë 03.01.2019, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht duke e ftuar (ii) për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
- xii. Më datë 07.01.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- xiii. Më datë 07.01.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, - vendosi të ftoj, - përmes postës elektronike, - subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin

55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 10 janar 2019.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Adrian Shega, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Peter Kijlstra. Në fillim të seancës dëgjimore, të datës 10 janar 2019, pasi u verifikua prezenca e subjektit të rivlerësimit dhe e vëzhguesit ndërkombëtar, përpara sesa të merrte fjalën relatori, nga ana e kryesuesit të seancës u kryen njoftimet e nevojshme për publikun dhe mediat prezent/e.
- ii. Më pas, e mori fjalën relatori i çështjes, i cili paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera, ku nëpërmjet shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, ishte konkluduar në rezultatet e njoftuara, mbi të tri kriteret;
- iii. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, z. Adrian Shega, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.
- iv. Gjithashtu, në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, ai kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.
- v. Seanca dëgjimore e datës 10.01.2019 u ndërpre, për të rifilluar më datë 11.01.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; c) raportin mbi Kontrollin e Figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) dokumentet shkresore të përcjella nga Shkolla e Magjistraturës; f) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; g) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit,

pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore; h) faktet e njohura botërisht.

A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar, me shkresën nr. (***), më datë 29.03.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega, ku konstatohet se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

I – Rivlerësimi i Pasurisë

1. Automjet, tip “Audi A6”, i prodhuar në vitin 2000.

- i. Kjo autoveturë rezulton e blerë me kontratën nr. (***) rep., të datës 22.01.2014, në vlerën prej 390.000 lekësh;
- ii. Subjekti në deklaratën e vitit 2014, para fillimit të detyrës, ka përshkruar si burim financiar për këtë blerje, kursimet nga të ardhurat;

- iii. Ndërsa, në deklaratën “Vetting” është deklaruar si burim financiar për blerjen e kësaj pasurie shitja e automjetit të mëparshëm në pronësi të subjektit, tipi “Fiat Punto”, kundrejt çmimit në vlerën prej 195.000 lekësh si dhe kursimet nga të ardhurat familjare;
- iv. Burimi i deklaruar i krijimit: Shitja e automjetit të mëparshëm dhe kursime nga të ardhurat.

Për këtë pasuri subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. Kontratë shitblerje, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 22.01.2014;
- ii. Certifikatë pronësie e mjetit nr. (***), datë 25.01.2014, me nr. shasie WA(***)8, me targë (***);
- iii. Kontratë shitblerjeje nr. (***)rep., nr(***)kol., datë 23.01.2014, për automjetin tip “Fiat Punto”, me targë A (***)J.

Konkluzioni i ILDKPKI-së në lidhje me këtë pasuri: *“Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e marrë nga DPSHTRR-ja”.*

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni:

- i. Komisioni ka nisur shkresën nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar DPSHTRR-së;
- ii. Me shkresën nr. (***)prot., datë 17.07.2018, DPSHTRR-ja ka informuar se: *“Pas verifikimit në sistemin informatik të DPSHTRR-së u gjetën të regjistruara në pronësi të shtetasit Adrian V. Sh., këto mjete:*
 - 1. “Fiat punto”, me targa A(***)J, me datë regjistrimi 03.01.2012, me status “Jo aktiv”;
 - 2. “Audi A6”, me targë A(***)U, me datë regjistrimi 23.01.2012, me status “Aktiv”;
 - 3. “Renault Clio”, me targë A(***)S, me datë regjistrimi 18.03.2008, me status “Çregjistrim i përhershëm”.
- iii. Me praktikën, nr. (***)prot., datë 24.07.2018, DPSHTRR-j ka vënë në dispozicion: *“Kopjet e dosjeve të njehsuara me origjinalin për automjetet me targa A(***)J dhe A (***)U;*
- iv. Komisioni gjithashtu, ka nisur një shkresë nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar AMF-së;
- v. Me shkresën nr. (***) prot., datë 25.07. 2018, AMF-JA, ka informuar se: *“Pranë shoqërisë së sigurimeve “S.. (***)” sh.a., rezulton se për shtetasin Adrian Shega është lëshuar policë sigurimi, Kartoni Jeshil, për periudhën 18.01.2018 – 01.02.2018, për mjetin me nr. shasie W (***) 8”.*
- vi. Më vonë është nisur një tjetër shkresë, me nr. (***) prot, datë 10.07.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- vii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 25.07.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka informuar se: *Z. Adrian V. Shega nga të dhënat e administruara në sistemin tatimor C@ts rezulton i regjistruar si person fizik me NIPT L ..(***) me aktivitet “Drejtësi dhe aktivitetet juridike” i regjistruar në organin tatimor, më datë 29.01.2013, me të ardhura të realizuara*

sipas deklaratave vjetore të dorëzuara, me fitim pas tatimit në shumën 487.527 lekë. Ndërsa prej datës 28.09.2017 figuron i çregjistruar nga organi tatimor;

- viii. Shkresë nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar ISSH-së;
- ix. Me shkresën nr. (***) prot., datë 16.07.2018, ISSH-ja ka vënë në dispozicion të dhëna për kontributet që prej vitit 2012 për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij;
- x. Gjithashtu është përcjellë një shkresë, nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar QKB-së;
- xi. Me shkresën nr. (***) prot., datë 25.07.2018, QKB-ja ka informuar se: *“Se shtetasi Adrian V. Shega rezulton me status të çregjistruar dhe për këtë ka vënë në dispozicion ekstraktin historik për të dhënat e tij si person fizik, pajisur me NIPT L.. (***)”*.

1.2 Analiza e provave:

- i. Nga aktet e administruara në dosjen e DPSHTRR-së, konfirmohet ekzistenca e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit.
- ii. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti me kontratën e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 22.01.2014, ka blerë nga shtetasi A. M. Sh., automjetin, tip “Audi 4B”, emërtimi tregtar A6, me targë A (***)U, me nr. shasie W (***) 8, në shumën 390.000 lekë. Në kontratë specifikohet se shuma për blerjen e automjetit është paguar përpara nënshkrimit të saj dhe në të njëjtën kohë është bërë edhe dorëzimi i automjetit.

1.2/a Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Shitja e automjetit, tip “Fiat”, me targë A(***)J.

Nga aktet rezulton se subjekti ka shitur me kontratën e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.01.2014, autoveturën, tip “Fiat 188 PUNTO”, me nr. shasie Z. (***)., me targë A(***)J, kundrejt çmimit në vlerën 195.000 lekë, të likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale, shtetasit R. Z.;

Për rrjedhojë, të sa më lart, konfirmohet burimi i pjesshëm që subjekti ka deklaruar se këto të ardhura kanë shërbyer për blerjen e autoveturës, tip “Audi - A6”.

1.2/b Kursimet nga të ardhurat:

Për të provuar aftësinë financiare të krijimit të kursimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioni kreu analizën financiare të pasqyruar në tabelën më poshtë.

Në këtë përlogaritje janë përfshirë:

- i. Të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit prej vitit 2006 dhe deri në deklarimin e tij para fillimit të detyrës, më datë 05.03.2014, ku konkretisht përfshihet;
- ii. Periudha e punësimit të subjektit pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë;
- iii. Të ardhurat e pasqyruara nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve, në shumën 487.527 lekë, për vitin 2013, - kohë në të cilën subjekti ka ushtruar aktivitetin privat si avokat;

- iv. Të ardhurat nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit prej periudhës maj 2013 e në vijim, për shkak se subjekti ka deklaruar fillimin e bashkëjetesës me bashkëshorten prej muajit maj,- dhe njëkohësisht ka provuar këtë lidhje martesore edhe me certifikatën e martesës lëshuar, më datë 24.10.2016, nga Njësia Bashkiake Nr. 3, Tiranë²;
- v. Të ardhurat nga personat e tjerë të lidhur, nëna³ e subjektit;
- vi. Shpenzimet e kryera duke përfshirë edhe shlyerjen e një kredie të marrë nga nëna e subjektit, disbursuar më datë 17.01.2014 dhe maturuar më datë 08.01.2016⁴;
- vii. Shitja e automjetit, më datë 23.01.2014, etj.

Si konkluzion, Komisioni, nga verifikimet dhe përlogaritjet e kryera lidhur me këtë pasuri, pasi ka analizuar dokumentacionin e administruar, të ndërthurur edhe me deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka konstatuar mospërputhje në deklaratime apo mungesë të burimit financiar për blerjen e këtij automjeti.

2. Analiza financiare

Në lidhje me të ardhurat nga punësimi pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë(Sh.L.F.T), deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Nga dokumentacioni i administruar, vërtetim i lëshuar nga SHLFT-ja⁵, rezulton se që prej vitit 2006 deri në vitin 2013 subjekti është angazhuar si avokat pranë këtij shërbimi prej të cilit ka përfituar shumat si më poshtë:

Viti 2006 - 3.285 euro.

Viti 2007 - 7.647 euro + 4.800 lekë.

Viti 2008 - 8.655 euro + 3.000 lekë.

Viti 2009 - 9.998 euro + 8.555 lekë.

Viti 2010 - 11.195 euro + 26.430 lekë + 295 USD.

Viti 2011 - 13.175 euro + 14.000 lekë.

Viti 2012 - 10.056 euro + 2.000 lekë.

Viti 2013 - 895 euro.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni:

- i. Komisioni ka përcjellë shkresën nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve të tjera jo bankare.

² Sipas certifikatës së martesës së subjektit të rivlerësimit në dosjen e ILDKPKI-së.

³ Shkresa nr. (***) prot., nga “Raiffeisen Bank” për të ardhurat nga paga për periudhën 2008 deri në shkurt të vitit 2014 të depozituara në këtë bankë, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shkresa nr. (***) prot., datë 13.07.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵ Vërtetim, datë 21.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së (aneksi 4/2).

- ii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 30.07.2018, “Intesa Sanpaolo Bank” ka konfirmuar derdhjet e shumave nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë.
- iii. Komisioni ka nisur shkresën nr (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar QKB-së.
- iv. Me shkresën nr. (***) prot., datë 25.07.2018, QKB-ja ka informuar se: “*Shtetasi Adrian Shega rezulton me status të çregjistruar dhe për këtë ka vënë në dispozicion ekstraktin historik për të dhënat e tij si person fizik, pajisur me NIPT L.. (***)*”.
- v. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektin të vënie në dispozicion të kopjeve të kontratave me këtë punëdhënësi si dhe dokumentacion mbi pagimin e detyrimit tatimor mbi të ardhurat e përfituara si dhe të kontributeve të tjera, vit pas viti, nga ku ka deklaruar.
- vi. Subjekti ka deklaruar⁶ se: “*...për vitin 2006, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, nuk dispononte dokumente financiarë dhe dokumente të tjera punësimi, në arkivin e tij, sipas vërtetimit, datë 11 shtator 2018, drejtores ekzekutive të TLAS, znj. R. B. Këto dokumente nuk janë ruajtur, pasi bazuar në Rregulloren e Brendshme të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë dhe politikave kontraktore të donatorëve që financojnë programin prej 20 vjetësh afati i ruajtjes së dokumenteve në arkiv brenda zyrës është maksimumi 10 vjet dhe TLAS nuk i disponon këtë dokumente për vitin 2006*”.
- vii. Për vitin 2007, kontrata e punës, datë 08.01.2007, lidhur midis Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 2) është 728 euro në muaj.
- viii. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 1. Kontratën e punës (7 fletë);
 2. Pagën për vitin 2007 (21 fletë);
 3. Sigurime + tatime për vitin 2007 (59 fletë).
- ix. **Për vitin 2008**, kontrata e punës, datë 08.01.2008, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 2) është 862 euro.
- x. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 1. Kontratën e punës (7 fletë);
 2. Pagën për vitin 2008 (19 fletë);
 3. Sigurimet + tatimet për vitin 2008 (57 fletë).
- xi. **Për vitin 2009**, kontrata e punës, përfunduar dhe nënshkruar, më datë 05.01.2009, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 2) është 900 euro.
- xii. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 1. Kontratën e punës (5 fletë);
 2. Pagën për vitin 2009 (24 fletë);
 3. Sigurime + tatime për vitin 2009 (59 fletë).
- xiii. **Për vitin 2010**, kontrata e punës, përfunduar dhe nënshkruar, më datë 20.01.2010, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 4) është 1.046 euro.

⁶ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

Kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë deri, më datë 30.09.2010, kontrata e punës përfunduar dhe nënshkruar, më datë 01.10.2010, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit paga e përcaktuar në kontratë (neni 4) është 1.296 euro në muaj. Kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë deri më datë 30.12.2010.

- xiv. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 - 1. Kontratën e punës, datë 20.01.2010 (6 fletë);
 - 2. Kontratën e punës, datë 01.10.2010 (6 fletë);
 - 3. Pagën për vitin 2010 (25 fletë);
 - 4. Sigurime + tatime për vitin 2010 (80 fletë).
- xv. **Për vitin 2011**, kontrata e punës, përfunduar dhe nënshkruar, më datën 20.01.2011, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 4) është 1.296 euro.
- xvi. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 - 1. Kontratën e punës (6 fletë);
 - 2. Pagën për vitin 2011 (21 fletë);
 - 3. Sigurime + tatime për vitin 2011 (84 fletë).
- xvii. **Për vitin 2012**, kontrata e punës, përfunduar dhe nënshkruar, më datën 01.01.2012, lidhur ndërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në cilësinë e punëdhënësit dhe z. Adrian Shega në cilësinë e punëmarrësit. Paga e përcaktuar në kontratë (neni 4) është 1.296 euro.
- xviii. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 - 1. Kontratën e punës (5 fletë);
 - 2. Pagën për vitin 2012 (31 fletë);
 - 3. Sigurime + tatime për vitin 2012 (79 fletë).
- xix. **Për vitin 2013, subjekti ka sqaruar** paraprakisht se, të dhënat e deklaruara në vërtetimin e dorëzuar janë të pasakta, pasi gjatë kësaj periudhe nuk kam qenë i punësuar pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS), por kam qenë i regjistruar si person fizik, “Adrian Shega”, me objekt veprimtarie, “Shërbime Avokatie”. Një ndër subjekte që i kam ofruar shërbime juridike dhe avokatie ka qenë edhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), shërbime për të cilat janë prerë faturat përkatëse tatimore dhe janë paguar të gjithë detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Sa më sipër deklaroj se për vitin 2013 nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) kam përfituar shumën neto prej 560.853 lekë.
- xx. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 - 1. Faturat tatimore mars - dhjetor 2013 (10 fletë);
 - 2. Formularë pagese TVSH, sigurime shoqërore dhe mandatarkëtime (31 fletë).

2.2 Analiza e provave:

Komisioni konstatoi se nga dokumentet e depozituara nga subjekti provohen marrëdhëniet kontraktore të subjektit me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS), të drejtat dhe detyrimet

kontraktore, paga përfituese e tij vit pas viti si dhe shlyerjet e detyrimeve tatimore dhe kontributet përkatëse prej vetë subjektit, pasi ky detyrim është mirëpërcaktuar në kontratën individuale të punës me këtë organizatë. Të dhënat e dokumentuara përputhen edhe me transaksionet bankare të bëra nga organizmi punëdhënës pranë “Intesa Sanpaolo Bank”.

Përshkrimi	Periudha 2006 - 05.03.2014 Shumat në lekë
1. Pasuri	840,000
Automjet, tip “Audi A6”, viti 2000, A (***)U	390,000
Kursime <i>cash</i> para fillimit të detyrës ⁷	450,000
2. Të ardhura	12,010,704
Të ardhura nga paga bashkëshortja ⁸	473,956
Të ardhura nga paga e nënës së subjektit ⁹	3,108,660
Të ardhura nga shitja e makinës ¹⁰	195,000
Të ardhura nga avokatia e subjektit sipas tatimeve ¹¹	487,527
Të ardhura nga T.L.A.S për të cilat janë paguar tatimet ¹²	7,745,561
4. Shpenzime	6,364,729
Shpenzime për shlyerje kredie BSH e subjektit të rivlerësimit ¹³	44,274
Shpenzime për udhëtime ¹⁴	747,122
Shpenzime jetese ¹⁵	5,573,333
Diferenca (2-1-4)	4,805,974

Analiza financiare, përmbledhëse, për subjektin e rivlerësimit, z. Adrian Shega, për periudhën 2014 - 2016 (vite në të cilat ai ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor):

	2014	2015	2016
1. PASURI	141,886	363,862	-99,009
Automjet, tip “Audi A6”, viti 2000, A (***)U	390,000		
Apartament banimi (shitesë anësore) me sip.18.10 m ² fituar pronësia me legalizim		15,800	
Ndryshim likuiditeti	-248,114	348,062	-99,009

⁷ Sipas dekarimit të bërë nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës (viti 2014);

⁸ Në dosjen e ILDKPKI-së është vërtetimi i DPSHTRR-së, nr. (***) prot., datë 20.01.2017, transaksionet në “Union Bank” bashkangjitur për periudhën janar - dhjetor dhe transaksionet e “BKT”-së për periudhën dhjetor 2013 - janar 2014. Për periudhën maj 2013 kur ka deklaruar bashkëjetesën deri, më datë 05.03.2014. Informacioni i marrë nga “Union Bank” dhe “BKT”-së për derdhjet në llogari nga institucioni ku ka punuar dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

⁹ Sipas shkresës nr. (***) prot., nga “Raiffeisen Bank” për të ardhurat nga paga për periudhën 2008 deri në shkurt të vitit 2014 të depozituara në këtë bank, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Sipas shkresës nr. (***) prot., datë 17.07.2018, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit

¹¹ Shih në dosje përgjigjen e dhënë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nr. (***) prot., datë 25.07.2018, në dosjen e Komisionit.

¹² Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në përgjigjen e pikës nr. 4 të pyetësorit nr. 2, për pagesën e kontributeve dhe tatimeve për të ardhurat nga paga nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹³ Bashkëshortja e subjektit ka qenë bashkëhuamarrëse me nënën dhe babain e saj dhe është konsideruar në përlllogaritje pjesa takuese e shlyerjes nga ana e saj, nga maji deri në tetor të vitit 2013, në shumën 44.274 lekë.

¹⁴ Shpenzimet për udhëtime të rezultuara nga sistemi TIMS për periudhën 2006 - mars 2014

¹⁵ Të përlllogaritura për periudhën 2006 - mars 2014, sipas përbërjes familjare të subjektit, bazuar tek shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së.

2. DETYRIME	231,773	-152,529	-22,159
Kredi bankare marrë në vitin 2012 nga bashkëshortja e subjektit në "Raiffeisen Bank"	-18,227	-19,887	
Kredi bankare mamaja e subjektit në vitin 2014	250,000	-132,642	-22,159
3. PASURI NETO	-89,887	516,390	-76,850
4. TË ARDHURA	1,957,740	2,531,081	2,556,098
Nga shitja e autoveturës	195,000		
Nga paga nëna së subjektit	465,668	456,120	524,340
Nga paga e subjektit	902,176	1,213,173	1,229,352
Nga paga e bashkëshortes së subjektit	394,896	861,788	802,406
5. SHPENZIME	1,738,804	1,619,465	1,777,117
Për shlyerje kredie	121,200	13,149	10,451
Jetese	1,100,000	1,100,000	1,100,000
Mobilimi ¹⁶	266,667	266,667	266,667
Me kartë krediti	229,921	219,001	0
Udhëtimi nga sistemi <i>TIMS</i>	21,017	20,648	400,000
DIFERENCA (4-3-5)	308,824	395,226	855,831

Në konkluzion, Komisioni, konstaton se nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime për blerjen e pasurisë automjet si dhe për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 450.000 lekë, siç ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 2014.

2.3 Në lidhje me deklarinin e gjendjes *cash*:

- i. Subjekti në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, për vitin 2014, ka deklaruar gjendje *cash*, shumën prej **450.000 lekësh**, me burim krijimi, kursime nga aktiviteti privat dhe të ardhurat e bashkëshortes.
- ii. Subjekti në përshkrimin e të ardhurave në po këtë deklaratë ka deklaruar shumën e të ardhurave si person fizik "Avokat" vlerën 0 (zero) lekë. Kjo rrethanë dukej si mospërputhje midis këtyre dy përshkrimeve (si më lart) në të njëjtën deklaratë.
- iii. Në deklaratën për "Vetting" *cash*, në vlerën prej 800.000 lekësh. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i deklaruar i krijimit: Kursime nga të ardhurat.

2.3/a Lidhur me aftësinë financiare të krijimit të gjendjes *cash*:

- iv. Paraprakisht për të arritur në një analizë të saktë financiare, subjekti është pyetur se sa ka qenë gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, respektivisht për periudhën 2014 - 2016?
- v. Subjekti ka sqaruar¹⁷:

¹⁶ Shih deklarinin e subjektit në pyetësin nr.1 në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Referojuni përgjigjeve të pyetësin nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

1. Në vitin 2014, gjendja cash, në datën 31 dhjetor 2014, ka qenë në shumën 400.000 lekë.
 2. Në vitin 2015, gjendja cash, në datën 31 dhjetor 2015, ka qenë në shumën 830.000 lekë.
 3. Në vitin 2016, gjendja në cash, në datën 31 dhjetor 2016, ka qenë në shumën 800.000 lekë.
 4. Në lidhje me gjendjen cash, sqaroj se, si pasojë e mungesës së informacionit në lidhje me mënyrën e deklarimit të asetëve apo gjendjes së pasurisë, në mënyrë të pasaktë në deklaratën vjetore të deklarimit të pasurisë të vitit 2014 kam deklaruar gjendjen totale të likuiditeteve cash dhe jo shtimin apo pakësimin.
 5. Pasi jam informuar mbi mënyrën e saktë të plotësimit të deklaratës vjetore të deklarimit të pasurisë, në vitet pasardhëse 2015, 2016, 2017, kam deklaruar vetëm ndryshimet e gjendjes cash, pakësim ose shtim dhe jo gjendjen totale të likuiditeteve cash.
 6. Në lidhje me sa sipër, jam paraqitur pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në datën 18 tetor 2016, ku ndër të tjera kam sqaruar përpara inspektorit, z. M. B., sipas procesverbalit të mbajtur po në këtë datë dhe të nënshkruar prej meje edhe situatën e krijuar me gjendjen e likuiditeteve cash.
 7. Konkretisht në pyetjen 9, të kryer nga inspektori se: A keni për të deklaruar gjë tjetër?, kam sqaruar se: “Po. Deklaroj se në deklaratën PV të vitit 2014 ku kam deklaruar gjendjen cash në shumën 400.000 lekë, dua të sqaroj se kjo shumë është gjendja totale dhe jo shtesa për këtë vit. Në fund të vitit 2015 gjendja totale cash ka qenë në shumën 830.000 lekë.”
- vi. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion një kopje të procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, mbajtur më datë 18.10.2016, mes Adrian Shega (subjekti deklarues) dhe M. B. (inspektor i lartë, pranë ILDKPKI-së), (2 fletë).
- vii. Më tej, Komisioni duke marrë në konsideratë edhe deklaratimet/sqarimet e subjektit, ka kryer përlllogaritjet financiare lidhur me aftësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të, për të krijuar gjendjen cash, nga ku ka rezultuar siç pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Viti	2016
Të ardhura	2,556,098
Nga paga e nënës së subjektit	524,340
Nga paga e subjektit	1,229,352
Nga paga e bashkëshortes së subjektit	802,406
Shpenzime	1,799,277
Shpenzime jetese	1,100,000
Shpenzime udhëtimi	400,000
Shpenzime mobilimi	266,667
Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga mamaja e subjektit(principal+int)	32,610
Likuiditete në fillim të vitit	614,525
Likuiditete në fund të vitit	515,475
Diferenca (Të ardhura-Shpenzime+Likuiditete në fillim-Likuiditete në fund)	855,831

Si konkluzion, nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar kursimet *cash* në vlerën 800.000 lekë.

2.3/b Llogari rrjedhëse në lekë, pranë “Credins Bank”, në vlerën 209 lekë, në pjesë takuese 5 %. Lidhur me këtë llogari bankare ILDKPKI-ja ka arritur në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e marrë nga “Credins Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- i. Komisioni ka përcjellë një shkresë nr. (***) prot, datë 10.07.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve të tjera jo bankare;
- ii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 10.07.2018, “Credins Bank” ka informuar se: “Z. Adrian V. Shega është klientë pranë “Credins Bank” dhe për këtë ka vënë në dispozicion edhe printime të llogarive të disponuara për periudhën prej çeljes së llogarisë dhe deri më datë 30.11.2018”;
- iii. Komisioni konkludon se nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank”, konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

2.3/c Llogari kartë krediti në euro “First Investement Bank”, limiti në vlerën 2.000 euro.

Për këtë aset subjekti nuk ka paraqitur dokumente justifikuese.

Lidhur me këtë llogari bankare ILDKPKI-ja ka arritur në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e marrë nga “Fibank”;

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- i. Komisioni ka përcjelle shkresën me nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve të tjera jo bankare;
- ii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 13.07.2018, “First Investement Bank” ka informuar se: “Shtetasi Adrian V. Shega, ka një kartë krediti me limit në vlerën 2.000 euro, e disbursuar, më datë 20.11.2008, e rinovuar, më datë 30.11.2014 dhe më datë 17.08.2015, me datë maturimi 31.08.2018”.

Si konkluzion, Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “First Investement Bank”, konstatohen se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

2.3/d Llogari kartë krediti në euro, “First Investement Bank”, limiti në vlerën 350 euro dhe llogari rrjedhëse në lekë, Banka Kombëtare Tregtare, në emër të bashkëshortes së subjektit në vlerën 0 (zero) lekë, në pjesë takuese: 50 %.

Edhe për këto dy llogari të subjektit, Komisioni, ka kryer verifikimet e duhura dhe ka arritur në përfundimin se nuk janë konstatuar parregullsi apo mospërputhshmëri.

1. PASURI TË DEKLARUARA NGA BABAI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. V. Sh. (babai i subjektit të rivlerësimit), në cilësinë e personit të lidhur, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar pasuri si vijon:

A. Apartament banimi, me sipërfaqe 50 m², ndodhur në ZK (***), me nr (***), në vlerën 11.000 lekë, ndodhur në ZK (***), fituar me kontratën e privatizimit nga shteti në vitin 1995, në vlerën 11.000 lekë. Pjesa zotëruese: 50 %.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- i. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. (***), datë 24.04.2013, për pasurinë me nr. (***), e llojit apartament, me sip. 50 m², në pronësi të V. dhe V.Sh.
- ii. Kontratë shitblerjeje nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 01.03.1994, për apartament me sip. 50 m². Blerës V. dhe V. Sh.. Çmimi në vlerën 11.000 lekë.
- iii. Vërtetim nënshkrimi, nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 01.03.1994.
- iv. Kontratë për privatizimin e banesës, më datë 18.09.1993, e lidhur mes V. Sh. dhe Ndërmarrjes Komunale Banesa. Vlera 11.000 lekë.
- v. Kontratë shitblerjeje, me blerës V. Sh. dhe shitës Ndërmarrjen Komunale Banesa Nr. 1. Çmimi në vlerën 11.000 lekë.

3.A/1 Hetimi i kryer nga Komisioni:

- i. Komisioni me shkresën nr. (***), prot., datë 10.07.2018, i është drejtuar të gjitha ZVRPP-ve të vendit.
- ii. Me shkresën nr (***), prot., datë 27.06.2018, ZVRPP-ja Tiranë ka informuar se, z. V. Sh., ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me të dhënat si më poshtë: *“Pasuria nr. (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), lloji i pasurisë apartament, me sip. 50 m² (pasuri aktive)”*.

B. Apartament banimi (shitesë anësore), me sipërfaqe 18.10 m², ndodhur në ZK (***), me nr. (***), në vlerën 15.800 lekë, fituar pronësia me legalizim nga shteti në vitin 2015. Pjesa zotëruese: 50%.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- i. Certifikatë për vërtetim pronësie nr (***) , datë 22.9.2015, për pasurinë me nr. (***) , e llojit apartament, me sip. 18.10 m², në pronësi të z. V. Sh.
- ii. Leje legalizimi nr. (***) , datë 20.05.2015, për shtesë anësore në objektin ekzistues, në emër të z. V. Sh. dhe banorëve. Numri i kateve mbi tokë 5 (pesë).
- iii. Kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 04.07.2011. Blerës z. V. Sh. dhe banorët. Vlera 15.884 lekë.

3.B/1 Hetimi i kryer nga Komisioni, konsiston edhe për këtë pasuri, si më lart.

Shkresë nr (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar ZVRPP-ve në të gjithë vendin.

- i. Me shkresën nr. (***) prot., datë 27.06.2018, ZVRPP-ja Tiranë, ka informuar se z. V. Sh. ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me të dhënat si më poshtë: *“Pasuria nr. (***) , vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) , lloji i pasurisë, apartament, me sipërfaqe 18.10 m² (pasuri aktive)”*.
- ii. Gjithashtu, për këtë pasuri, Komisioni, ka përcjellë shkresën nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar ALUIZNI-t.
- iii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 26.07. 2018, ALUIZNI ka informuar se: *“Z. V. Sh., ka qenë subjekt i ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, sipas “Urdhër - Përfshirjes” në “Vetëdeklarimin” me nr. (***) prot., viti 2006, së bashku me banorët e tjerë dhe se është pajisur me lejen e legalizimit nr. (***) , datë 20.05.2015”*.
- iv. Me shkresë nr. (***) prot, datë 10.07.2018, Komisioni i është drejtuar “UKT”-së.
- v. Me shkresën nr. K- (***) prot., datë 20.07.2018, “UKT”-ja informon se: *“Shtetasi V. Sh., referuar të dhënave nga sistemi i menaxhimit të informacionit, identifikohet një abonent me kontratë nr. (***) , me adresë, Rr “(***)” , pll. (***) , shk. 1, ap. 11, Tiranë, kategoria “familjar”, me status “aktiv”, me detyrime të palikuiduara me vlerë 7.15 lekë deri më datë 16.07.2018”*.
- vi. Komisioni, gjithashtu ka përcjellë një shkresë, nr. (***) prot., datë 10.07.2018, drejtuar “OSHEE”-së.
- vii. Me shkresën nr. (***) prot., datë 09.08. 2018, “OSHEE”-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë furnizimi me energji elektrike me “OSHEE”-në .

3.B/2 Analiza e provave:

- i. Duke qenë se pasuria është një e vetme e përfituar pjesërisht nga privatizimi i banesave shtetërore dhe pjesërisht nga legalizimi i banesave informale trajtohet në tërësi analiza e provave të mbledhura gjatë hetimit administrativ.

- ii. Nga praktika e ZVRPP-së¹⁸, si dhe certifikatat e pronësisë¹⁹, provohet ekzistenca e kësaj pasurie së bashku me shtesën anësore në emër të personit të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së subjektit. Më konkretisht sipas kontratës për privatizimin e banesës, datë 18.09.1993, rezulton se apartamenti është ndërtuar në vitin 1985 dhe se në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, privatizohet në shumën 13.750 lekë në favor të z. V. Sh. Po ashtu bazuar në lejen e legalizimit, nr. (***) , datë 20.05.2015, z. V. Sh., ka regjistruar, më datë 22.09.2015, pjesën takuese, “*shtesë apartamenti ekzistues*”, provuar kjo me kartelën e pasurisë administruar në dosjen e ZVRPP-së Tiranë.
- iii. Gjithashtu edhe nga praktika e ALUIZNI-t konfirmohet shtesa e ndërtuar bri pasurisë apartament, formalizuar me lejen e legalizimit, nr. (***) , datë 20.05.2015, përmendur më sipër. Nga aktet rezulton se kjo shtesë është vetëdeklaruar, më datë 07.09.2006, si shtesa anësore e pallatit ekzistues 5-katësh, nr. (***) , shk. (***) , ap. (***) . Vetëdeklarimi është nënshkruar nga banorët përfitues të këtij ndërtimi ku ndër të tjerë është edhe z. V. Sh. Me kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 04.07.2011, rezulton se Agjencia e Legalizimit Integritit dhe Urbanizimit të Zonave /Ndërtimeve Informale i ka shitur banorëve të pallatit, ndër të tjerë edhe z. V. Sh., parcelën ndërtimore nr. (***) , me sip. 31.86 m², në shumën 64.720 lekë dhe 19.667 lekë taksë e ndikimit në infrastrukturë. Më tej me lejen e ndërtimit, nr. (***) , datë 20.05.2015, është legalizuar ndërtimi informal me sipërfaqe totale 131.78 m². Sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, datë 16.05.2011, vlera e të gjithë investimit pasqyrohet në shumën 3.733.722,74 lekë.
- iv. Për shkak se subjekti figuron në një gjendje familjare me prindërit e tij²⁰ dhe njëkohësisht jeton në këtë pasuri së bashku me ta, por edhe për faktin se në informacionin e dhënë nga QKB-ja për kohën në të cilën ai ka ushtruar aktivitetin e tij privat si avokat ka përdorur si adresë të ushtrimit të aktivitetit banesën në të cilën jeton, Komisioni ka pyetur subjektin në lidhje me raportin e tij në investimin e kryer mbi shtesën e kësaj pasurie si dhe raportin e tij me këtë pasuri.
- v. Subjekti ka sqaruar se²¹: “*Ky ndërtim është realizuar në vitin 2002, provuar kjo nga dokumenti aktmarrëveshje i vitit 2002, i lidhur midis shtetasit L. T. në cilësinë e përfaqësuesit të 10 familjeve dhe palës sipërmarrëse të punimeve ndërtimore përfaqësuar nga ing. E. D. dhe F. K.*
- vi. *Ky fakt rezulton nga dokumenti i titulluar, “Akt Ekspertizë, objekti shtesë anësore, në Rr. “(***)”, pll, (***) , shk. nr. (***) , Tiranë, lëshuar nga projektues – kolaudator, ing. E. D. Në seksionin I, “Të përgjithshme”, përshkruhet “... kjo shtesë është ndërtuar në vitin 2002 dhe është vazhdim i shtesës tjetër të ndërtuar nga pronarët... po në vitin 2002...”*

¹⁸ Referojuni dokumenteve bashkëngjitur shkresës nr. (***) prot., datë 27.06.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Referojuni certifikatës për vërtetim pronësie të ZVRPP-së Tiranë. Lëshuar më datë 24.04.2013 dhe certifikatës për vërtetim pronësie të ZVRPP-së Tiranë, lëshuar më datë 22.09.2015, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Referojuni certifikatës familjare lëshuar, më datë 20.01.2017, nga Njësia Bashkiake Nr. 3, Tiranë, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr.2 , datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

- vii. *Ky fakt rezulton nga dokumenti i titulluar, “Akt Ekspertizë, objekti shtesë anësore, në Rr “(***)”, pll. (***) , shk. nr. (***) , Tiranë”, lëshuar nga projektues – kolaudator, ing. E. D., dokument i cili i përket komshinjve të cilët kanë realizuar gjithashtu një shtesë anësore në pjesën e tyre të banimit. Në seksionin nr. 1, “Të përgjithshme”, përshkruhet “... shtesa është ndërtuar në vitin 2002 pa leje ndërtimi si shumica e shtesave të ndërtuara këto vite në Tiranë. Sipërfaqja e ndërtimit të shtesës është 28.33 m²”.*
- viii. *Në lidhje me faktin se nga cila kompani është realizuar ndërtimi deklaroj se ky ndërtim është realizuar nga punëtorë të kontraktuar nga projektuesi dhe kolaudatori i punimeve z. E. D., i cili njëkohësisht është edhe sipërmarrës i punimeve, sipas projektit të ing. S. S.*
- ix. *Ky fakt rezulton nga dokumenti, aktmarrëveshje e vitit 2002, i lidhur midis shtetasit L. T. në cilësinë e përfaqësuesit të 10 familjeve dhe palës sipërmarrëse të punimeve ndërtimore përfaqësuar nga ing. E. D. dhe F. K.*
- x. *Gjithashtu ky fakt rezulton edhe nga dokumenti i titulluar, “Akt Ekspertizë, objekti shtesë anësore, në Rr “(***)”, pll. (***) , shk. nr. (***) , Tiranë”, lëshuar nga projektues – kolaudator, ing. E. D., mbajtës i licencës nr. K. (***)”.*
- xi. *Në lidhje me vlerën e investimit të kryer për këtë pasuri deklaroj se për realizimin e ndërtimit të shtesës anësore me sip. 18.10 m² për ndërtimin e karabinasë dhe muraturës me tulla është paguar përafërsisht shuma prej 190 000 lekësh, shumë e cila i është paguar cash, sipërmarrësit.*
- xii. *Ky fakt rezulton nga dokumenti aktmarrëveshje i vitit 2002, i lidhur midis shtetasit L. T., në cilësinë e përfaqësuesit të 10 familjeve dhe palës sipërmarrëse të punimeve ndërtimore përfaqësuar nga ing. E. D. dhe F. K., ku sipas pikës 6 të aktmarrëveshjes përcaktohet se: “Çmimi i ndërtimit karabina me gjithë muraturë tulle është në vlerën 10.500 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi...”.*
- xiii. *Për sa i përket suvatimit të mureve dhe dritares, deklaroj se janë realizuar nga punonjës të tjerë të kontraktuar nga babai, po në vitin 2002. Në lidhje me shpenzimet për suvatim dhe vendosjen e dritares nuk kam informacion të saktë për shumën e paguar, pasi pagesat janë bërë cash nga prindërit.*
- xiv. *Në lidhje me raportin që kam me këtë pasuri deklaroj se kjo pasuri i përket prindërve të mi V. dhe V. Sh., të cilët janë pronarët e vetëm të saj sipas dokumentit, certifikatë pronësie të dorëzuar në deklaratën e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Kjo pasuri përdoret për banim prej meje, nga bashkëshortja M. Sh. dhe vajza K. Sh., bashkë me prindërit të cilët janë pronarë të saj.*
- xv. *Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie deklaroj se kjo pasuri është realizuar në vitin 2002 me kursimet nga punësimi të prindërve.*
- xvi. *Në lidhje me raportin tim me burimin e krijimit të kësaj pasurie deklaroj se kjo pasuri është realizuar në vitin 2002 me kursimet nga punësimi të prindërve dhe personalisht nuk kam kontribuar në realizimin e saj, pasi në vitin 2002 kur është realizuar ndërtimi kam qenë student i vitit të dytë pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe nuk kam qenë i angazhuar në marrëdhënie punësimi.*

Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. Praktikën nr (***) prot., datë 10.09.2018, lëshuar nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë 2 (35 fletë);
- ii. Fotokopje, “Akt Ekspertizë, objekti shtesë anësore, në Rr: “(***)”, pll. (***), shk. nr. (***), Tiranë”, lëshuar nga projektues – kolaudator, Ing. E. D.; (4 fletë)
- iii. Fotokopje, “Aktmarrëveshje e vitit 2002, e lidhur midis shtetasit L. T. në cilësinë e përfaqësuesit të 10 familjeve dhe palës sipërmarrëse të punimeve ndërtimore përfaqësuar nga ing. E. D. dhe F. K. ”; (2 fletë)
- iv. Fotokopje, “Planimetri punimesh”, realizuar nga ing. S. S. (7 fletë).

Në konkluzion, trupi gjykues, arrin në përfundimin se në lidhje me këto pasuri deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk ka pasur mangësi të burimeve financiare, për krijimin e tyre.

4. Në lidhje me pasaktësinë e vërejtur në Raportin e ILDKPKI-së.

- i. Në pyetjen e bërë²² mbi vërtetësinë, shkakun dhe debinë në emër të tij si dhe mbi veprimet e kryera prej tij nga urdhërimi i vendosjes së barrës siguroese deri në zhbllokimin e pasurisë, subjekti ka shpjeguar edhe lidhur me faktin e mosdeklarimit për herë të parë pranë ILDKPKI-së të automjetit të shitur në janar 2014.
- ii. **Në përgjigjen e dhënë subjekti ka sqaruar²³ se:** *“Për sa i përket automjetit me targë A(***)J, është shitur prej meje me kontratën e shitjes së automjetit nr (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.01.2014, pranë noterit publik I. Ç. Që nga ky moment jam zhveshur nga pronësia dhe posedimi mbi këtë automjet. Fakti që ky automjet rezulton pranë DPSHTRR-së ende në pronësinë time, vjen si rezultat i moskryerjes nga blerësi të veprimeve administrative për depozitimin e kontratës së shitjes dhe ndryshimin e pronësisë mbi mjetin. Këtë fakt e kam sqaruar edhe pranë ILDKPKI-së , në procesverbalin e mbajtur pranë inspektorit M. B., datë 18 tetor 2016, kur jam pyetur në lidhje me këtë pasuri dhe kam depozituar kontratën e shitjes së automjetit. Konkretisht në pyetjen nr. 1 të kryer nga inspektori se: Nga verifikimi pranë DPSHTRR-së është konstatuar se ju keni pasur në pronësi mjetin me targë A (***) J deri më datë 19.02.2014... ”.*
- iii. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 1. Kontratën e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.01.2014;
 2. Kopje të procesverbalit²⁴ mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, mbajtur më datë 18.10.2016, në Tiranë, midis subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega (subjekt deklarues) dhe z. M. B. (Inspektor i Lartë, pranë ILDKPKI-së 2 fletë).

²² Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

²³ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Referojuni procesverbalit bashkëngjitur përgjigjes së pyetjes 3 të pyetësorit nr.2 në dosjen e Komisionit.

- iv. Nga aktet, kontratë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.01.2014, rezulton se shitja e automjetit daton përpara datës së fillimit të detyrës në Gjykatën e Lartë në pozicionin e Ndhmësit Ligjor dhe për pasojë me të drejtë ai nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën para fillimit të detyrës pasuri për të cilat ai i ka pasur dhe është zhveshur nga pronësia.

Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet shpjeguese, si më lart, vlerëson se nuk rezulton e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer deklaratim të pasaktë në lidhje me pronësinë/posedimin e autoveturës në fjalë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

- i. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektin e rivlerësimit z. Adrian Shega”. Ky raport është deklasifikuar²⁵, më datë 20.07.2018.
- ii. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Qëndrimi i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës:

- iii. Nga hetimi administrativ, Komisioni, nuk konstatoi asnjë element që mund të çonte në prova apo në dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e mundshme të kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Në Komision nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë denoncim lidhur me figurën apo integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega.

Për sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si këshilltar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

C/1 – Vlerësimi i kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Sipas pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

²⁵ Vendim nr.172, datë 20.07.2018.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka përcjellë me shkresën nr. (***), datë 01.10.2018, “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega, për periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i. Formularit të vetëdeklarimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, tre dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit.
- ii. Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- iii. Të dhënat nga burimet arkivore.

C/1/a - FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, ndihmësi ligjor Adrian Shega, më datë 26.01.2017²⁶, ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, formularin e vetëdeklarimit, si dhe dokumentet shoqëruese.

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, me faqe të nënshkuara rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara, në Rubrikën B të Formularit, për periudhën 01.2007 - 12.2012, subjekti ka deklaruar periudhë pune si avokat pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë; për periudhën 01.2013 - 01.2014, subjekti ka deklaruar se ka punuar avokat privat, i vetëpunësuar i regjistruar si person fizik, avokat Adrian Shega; ndërsa në periudhën 03.02.2014 deri në datën 26.01.2017, ditë në të cilën ka dorëzuar formularin e vetëvlerësimit pranë KLD-së, subjekti ka deklaruar periudhë pune si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka deklaruar se tre vitet e fundit ka punuar si ndihmës ligjor pranë gjyqtarës A. F., e cila ka qenë në përbërje të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kryesisht fusha e veprimtarisë së tij ka qenë e lidhur me çështjet administrative.

Në lidhje me fushën e specializimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka deklaruar se është në proces të marrjes së titullit “Master jo profesional”, “E drejtë biznesi”.

Lidhur me të dhënat sasiore, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, në periudhën 03.02.2014 - 31.12.2016, i janë caktuar 540 çështje për relativim. Ai ka deklaruar se për funksionin që kryen nuk aplikohet mbartja e çështjeve. Këto të dhëna nuk shoqërohen me dokumentacion. Gjithashtu, konstatohet se në kohën e depozitimit të formularit të vetëvlerësimit pranë Inspektoratit, subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka pasur më pak se 3 vjet punë në detyrën e ndihmësit ligjor.

d) Trajnimet në 3 vitet e fundit

²⁶ Ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka deklaruar se nuk ka kryer trajnime në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës subjekti ka deklaruar dhe paraqitur certifikatat përkatëse për pjesëmarrje të tij si student i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike për vitin 2009, organizuar nga Këshilli i Evropës në periudhën janar - qershor 2009, në Shkollën Verore me temë “Demokracia e Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës”, organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg, Francë, në datat 6 -10 korrik 2009, në seminar me temë “Kolegji i Avokatëve”, organizuar nga “(***)”, në San Francisko, Kaliforni, SHBA, në muajin tetor 2007, si dhe në Shkollën Verore me temë “Sistemi Evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”, organizuar nga “Universiteti i V. (***)”, në Frankfurt O., Gjermani, në datat 10 - 21 shtator 2007, pjesëmarrje që datojnë jashtë periudhës së rivlerësimit.

Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tre relacione në emër të tij por pa nënshkrimin përkatës. Në të tre relacionet nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, nëse janë brenda apo jashtë periudhës objekt rivlerësimi.

Analiza e tyre paraqitet më poshtë:

1. Dokumenti 1. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2012.

Në këtë relacion është sugjeruar - *“Sa më sipër në vlerësim të kolegjit nëse rekursi i paraqitur përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012”*.

Në përfundim nuk është dhënë asnjë mendim nëse se rekursi përmban ose jo shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Relacioni rezulton të jetë i paplotë pasi atij i mungon analiza ligjore e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe analiza ligjore e vendimit të Gjykatës së Apelit, si dhe i mungon propozimi për zgjidhjen konkrete të çështjes. Shkaqet e rekursit nga pala e paditur lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material (neni 114, pika 1, e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008), nga Gjykata e Apelit në rastin konkret. Ndhmësi ligjor nuk ka dhënë asnjë mendim nëse janë të bazuara shkaqet e rekursit në ligj dhe nëse është zbatuar drejt apo gabim nga Gjykata e Apelit ligji material i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Çmohet se mendimit ligjor në këtë rast i mungon pjesa thelbësore e tij që është analiza ligjore e pretendimeve të parashtruara në rekurs sipas parashikimit të bërë në nenin 472, pika 1, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile, si dhe propozimi i ndihmësit për mënyrën se si duhet të disponojë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin konkret.

2. Dokumenti 2. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2012.

Në këtë relacion është vlerësuar se: *“Në vlerësim të kolegjit nëse rekursi përmban shkaqe për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit”*.

Relacioni rezulton të jetë pjesërisht i saktë. Ndhmësi ligjor është ndalur në analizën ligjore të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (për vendimin e Gjykatës së Apelit nuk është shprehur

fare), duke arsyetuar se në vendim ajo gjykatë nuk iu ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve, se nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm dhe se qëndron pretendimi i parashtruar në rekurs, se gjykata nuk është shprehur për një pjesë të kërtimeve të parashtruara në padi. Megjithatë, subjekti i rivlerësimit, nuk jep asnjë përgjigje për faktin nëse shkeljet e evidentuara në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, të cilat janë të natyrës procedurale, a janë të tilla që sjellin si pasojë prishjen e atij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Nuk analizohet nëse ka pasur zbatim të gabuar të ligjit procedural nga gjykata apo shkelje të rëndë të normave procedurale që sjellin si pasojë pavlefshmërinë e atij vendimi. Nga subjekti nuk thuhet asnjë fjalë nëse në rekursin e palës së paditur ka shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nga përmbajtja e shkaqeve që ajo palë ka parashtruar në rekurs ngrihen vetëm pretendime për zgjidhjen në themel të çështjes nga gjykatat, por nuk përmendet në asnjë rresht të rekursit nëse gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt apo gabim ligjin material apo procedural. Ndërkohë, ka një pretendim për zbatim të gabuar të ligjit procedural vetëm në rekursin e Avokaturës së Shtetit. Ndihmësi ligjor e konsideron të drejtë këtë pretendim por nuk sqaron se çfarë pasojë sjell kjo shkelje në vlefshmërinë e atij vendimi. Së fundmi, ndihmësi nuk jep asnjë propozim për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Administrativ, për mënyrën e disponimit nga ana e tij me vendim përfundimtar, por shprehet se e lë në vlerësim të kolegjit nëse rekursi përmban shkaqe për cenimin e vendimit të apelit dhe harron fare të shprehet për vendimin e shkallës së parë.

3. Dokumenti 3. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2011.

Në këtë relacion është vlerësuar se: *“Në vlerësim të kolegjit nëse rekursi përmban shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, relacioni rezulton të jetë pjesërisht i saktë”*. Arsyet që mbështesin këtë përfundim janë si më poshtë:

Së pari, ndihmësi ligjor nuk jep asnjë shpjegim nëse rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikohen shprehimisht në nenin 472 të Kodit të Procedurës së Civile.

Së dyti, subjekti merr në analizë disponimin (vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë) duke arsyetuar sipas tij disa gabime të kryera nga gjykata të tilla si mosmarrja në shqyrtim e kundërpadisë së ngritur nga i padituri F. H., mosarsyetimi nga gjykata dhe mosmarrja në analizë e përbërjes familjare për të ndjerin M. S., në gusht të vitit 1991, etj, por nuk sqaron se çfarë pasojash sjellin për vendimin e dhënë këto shkelje të kryera nga gjykata. Ai nuk sqaron nëse këto shkelje e bëjnë të pavlefshëm vendimin gjyqësor dhe nëse shkeljet janë të tilla që pasjellin ndryshimin e atij vendimi nga Gjykata e Lartë apo shkeljet procedurale të evidentuara kanë pasojë kthimin e çështjes për rigjykim. Gjithashtu, subjekti merr në analizë rastin se kur nxirret një çështje nga gjykata jashtë juridiksionit gjyqësor, kur në fakt as gjykata e faktit dhe as ajo e apelit nuk kanë vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, por kanë pranuar tërësisht padinë e palës paditëse. Mungesa e juridiksionit nuk ka qenë fare çështje për tu zgjidhur nëpërmjet rekursit të ngritur nga i padituri. Së fundi, subjekti nuk propozon asnjë mënyrë zgjidhje për çështjen, por shprehet se e lë atë në *“Vlerësim të Kolegjit të Gjykatës së Lartë”*.

- Në tërësi, në të tre relacionet, vërehet se nga pikëpamja formale janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe.

C/1/b - RAPORTI I 5 DOSJEVE TË SUBJEKTIT TË PËRZGJEDHUR ME SHORT

1. Dokumenti 4. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2011.

Në këtë relacion ndihmësi ligjor, z. Adrian Shega, ka dhënë mendimin: *“Se rekursi nuk përmban shkaqe të parashikuara nga ato të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka vend të cenohet”.*

Konstatohet se propozimi i ndihmësit ligjor për mënyrën e zgjidhjes së çështjes përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ky kolegji me vendimin nr. 00-2014-1517, datë 03.06.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës së paditur.

Relacioni përmban elementët e parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014, të kryetarit të kësaj gjykate. Ai pasqyron qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në recurs.

2. Dokumenti 5. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2013.

Në këtë relacion ndihmësi ligjor, z. Adrian Shega, ka dhënë mendimin: *“Në vlerësim të Kolegjit nëse rekursi përmban shkaqe të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012”.*

Rezulton se konkluzionet e arritura nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2015-5453(664), datë 03.12.2015, janë të kundërta me propozimin që bën ndihmësi ligjor për mënyrën e zgjidhjes së çështjes në Gjykatën e Lartë. Ndihmësi e konsideron të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërsa Kolegji arsyeton në të kundërt dhe në fund e ka prishur atë vendim duke e dërguar çështjen për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Kolegji ka argumentuar se gjykatat e faktit kanë kryer një hetim të mangët gjyqësor dhe nuk kanë analizuar drejt ligjshmërinë e aktit administrativ objekt kundërshtimi gjyqësor dhe se vendimi për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga prishja e objektit është i paarsyetuar.

Konstatohet se ndihmësi ligjor nuk ka arritur të analizojë drejt shkaqet e rekursit dhe nuk është orientuar dot për mënyrën se si duhet të dispononte Kolegji në këtë rast.

3. Dokumenti 6. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2013.

Në këtë relacion ndihmësi ligjor, z. Adrian Shega, ka dhënë mendimin: *“Rekursi rezulton të jetë në afat dhe i komunikuar rregullisht. ... Vlerësoj që të shqyrtohet nga Kolegji fakti nëse në kushtet kur palës i ka mbaruar kjo leje dhe ligji i ri nuk parashikon ndonjë dispozitë të tij se si do të procedohet me lejet e reja a mund të bëhet transformimi i lejes së kërkimit në leje kërkim zbulimi apo kushtet e nenit 57 pala paditëse duhej t'i drejtohej të paditurit “(***)” me kërkesë të re sipas parashikimeve të reja ligjore për t'u pajisur me leje për kërkim zbulimi”.*

Në drejtim të evidentimit të problematikave të zbatimit të ligjit material për zgjidhjen e çështjes, ky relacion rezulton të jetë formal. *Nuk ka asnjë argument ligjor dhe nuk ka asnjë lloj analize të ndihmësit mbi shkaqet e rekursit apo mbi ligjshmërinë e vendimit të dhënë nga secila prej gjykatave të faktit, si dhe se ai nuk ka arritur të orientohet për mënyrën se si duhet të dispononte*

Kolegji në këtë rast, i cili prishi si të gabuar vendimin e gjykatës së apelit dhe la në fuqi si të drejtë e ligjor vendimin e gjykatës së rrethit.

4. Dokumenti 7. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2014.

Në këtë relacion ndihmësi ligjor ka dhënë mendimin: “Rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor. Rekursi i është komunikuar palëve. Sikurse rezulton vendimi i Gjykatës së Apelit është shpallur, më datë 17.12.2013, ndërsa më datë 04.11.2013, ka hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative. Me vendimin unifikues nr. 3/2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar qëndrimin duke përcaktuar se: Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49/2012, datë 03.05.2012, janë kompetente për çështjet administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar”.

Konstatohet se propozimi i ndihmësit ligjor për mënyrën e zgjidhjes së çështjes përputhet plotësisht me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ, i cili me vendimin nr. 00-2016-2612, datë 28.06.2016, prishi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e dërgoi çështjen për kompetencë gjykimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Relacioni përmban elementët e parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë. Ai pasqyron qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs dhe kundërekurs.

5. Dokumenti 8. Relacion për çështjen administrative nr. (***) -2011

Në këtë relacion ndihmësi ligjor ka dhënë mendimin se: “Pretendimet e ngritura në rekurs nga avokatura e shtetit nuk përmbajnë shkaqe ligjore të parashikuara në ligj. Nga studimi i akteve të dosjes gjyqësore konstatohet se Gjykata e Apelit ka bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm dhe e ka zgjidhur drejtë mosmarrëveshjen objekt gjykimi”.

Rezulton se propozimi i ndihmësit për të mos cenuar vendimet e gjykatave të faktit ka gjetur përputhje me përfundimet e arritura nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2015-1615(273), datë 05.05.2015.

Në tërësi, rezulton se në këto pesë dokumente paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, ndonëse të panumërtuar. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore, ndërsa, nuk kanë datë të hartimit të tyre.

C/1/c - TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

Nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, deri në dorëzimin e formularit nuk ka ushtruar asnjëherë

funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të shkallës së parë apo apeli. Rrjedhimisht për këtë subjekt, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk disponohen të dhëna për veprimtarinë e tij.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka aftësi mesatare në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e tij në të drejtën administrative, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ai ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – ndihmës ligjor në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

b) Arsyetimi ligjor

Në drejtim të arsyetimit ligjor u konstatuan dy standarde në punën e subjektit të pasqyruara në tre dokumentet e përzgjedhura prej tij, si dhe në pesë dokumentet e përzgjedhura me short. Në disa raste, ndihmësi argumenton ligjërisht mendimin e tij dhe propozon zgjidhje konkrete të çështjes për Kolegjin, referuar dokumentit 4 dhe 7, ndërsa ka relacione, si në dokumentet 6 dhe 8, ku arsyetimi ligjor mungon krejtësisht apo ku arsyetimi i ndihmësit si në dokumentin 5, nuk përputhet me atë të Kolegjit. Ndërkohë, mendimi i ndihmësit ligjor dhënë në dokumentet 4, 7 dhe 8, përputhet me vendimmarrjen e gjykatës.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, në periudhën 03.02.2014 - 08.10.2016 (**më pak se 3 vjet**), ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarës A. F. në Gjykatën e Lartë. Këtë detyrë rezulton ta ketë ushtruar të paktën deri në datën 26.01.2017, ditë në të cilën ka depozituar dokumentacionin përkatës pranë KLD-së . Ai ka deklaruar në Formularin e Vetëvlerësimit se në periudhën 03.02.2014 - 31.12.2016, i janë caktuar 540 çështje për relativim.

Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentet ligjorë, rezulton se ndihmësi ligjor, z. Adrian Shega, ka relatuar 531 dosje, nga të cilat 3 dosje e kanë kopjen e aktit të hartuar nga ndihmësi, ndërsa 38 dosje nuk e kishin të përfshirë relacionin e ndihmësit ose relacioni ishte pa emër.

Në analizën e këtyre të dhënave duhen evidentuar këto faktorë: (i) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (ii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativim dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësi ligjor, bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësit ligjor të përzgjedhur me short për vlerësim.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Në të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast, ndihmësi ligjor ka studiuar çështjen gjyqësore që ka relatuar në çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit apo kundër rekursit. Këto veprime ai i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar (edhe pse në disa raste formalisht) elementët proceduralë të kërkuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014, të kryetarit të kësaj gjykate.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Theksohet se në asnjë prej dokumenteve të paraqitur dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë, kjo edhe për shkak të natyrës së punës. Për ndihmësin ligjor, z. Adrian Shega, nuk ka të depozituar akte vlerësimi profesionale nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e subjektit në funksion.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, dhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega. Asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 relacionet e vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në të 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega, me palët ndërgjyqëse pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta,

ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, më datë 30.06.2005. Në formularin e vetëvlerësimit subjekti ka deklaruar se është duke kryer studimet për marrjen e titullit “Master joprofesional”, në degën “E drejtë biznesi”, pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Subjekti ka fituar edhe të drejtën për të ushtruar profesionin e avokatit. Ai është emëruar si ndihmës ligjor në Gjykatë të Lartë në datën 03 shkurt 2014. Ai ka kërkuar vazhdimin e procedurës së rivlerësimit duke paraqitur kërkesë pas përfundimit të detyrës së ndihmësit ligjor. Këto të dhëna dokumentohen rregullisht me aktet, që janë pjesë e dosjes së tij të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka trajnime në Shkollën e Magjistraturës me argumentin se ligji nuk ka parashikuar përfshirjen e këshilltarëve ligjore jomagjistratë në trajnimet e zhvilluara nga ky institucion. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës subjekti ka deklaruar pjesëmarrjen në 4 aktivitete trajnuese, të cilat janë përpara periudhës së rivlerësimit, në vitet 2007 dhe 2009.

Denoncimet nga publiku

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk janë paraqitur denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit ligjor të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

C/2 - RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e Inspektoratit të KLD-së si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, - duke pasur parasysh faktin që, z. Adrian Shega, ka pasur funksionin e këshilltarit ligjor, si dhe që i është nënshtruar testimi të Shkollës së Magjistraturës, ku aktualisht është student, - ka kryer një rivlerësim tërësor të kriterit profesional, nëpërmjet një kombinimi të balancuar midis raportit të sipërpërmendur dhe vlerësimit/rezultatit të testimit profesional të kryer nga SH. M.

Duke qenë se mbi raportin e Inspektoratit të KLD-së u sqarua sa më lart, vijojmë me elementin tjetër, të marrë në konsideratë së bashku me informacione të tjera të marra nga Komisioni, për të përfunduar pastaj me propozimet/konkluzionet sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

C/2/A - REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. (***) prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimi të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rezulton se, me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, nr. 17, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimi, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj të vitit 2018.

Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimi të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, ka marrë 61 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë ka marrë 154 pikë nga 200 të mundshme.

Ndërsa me shkresën nr. (***) prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës konfirmon se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, *subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjekë programin dyvjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.*

C/2/B - TË DHËNA NGA GJYKATA E LARTË

Me shkresën nr. (***) prot., datë 03.08.2018, i jemi drejtuar Gjykatës së Lartë, duke i kërkuar informacion nëse ka pasur/ka procedim disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega, ndihmës ligjor pranë kësaj gjykate.

Gjykata e Lartë, me shkresën nr. (***) prot., datë 08.08.2018, konfirmon se lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Adrian Shega, **nuk rezulton të ketë pasur procedim disiplinor.**

C/2/C - LIDHUR ME VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË RIVLERËSIMIT

Paraprakisht subjekti i rivlerësimit gjatë procedurës së shortit të organizuar, më datë 20.09.2018, ka dorëzuar një kërkesë me shkrim për grupin e punës ku evidentohet fakti, se ai dëshiron të vazhdojë procedura e rivlerësimit pavarësisht se i ka përfunduar detyra si ndihmës ligjor pranë kësaj gjykate, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarës më të cilën ai ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor. E njëjta kërkesë rezulton e dorëzuar edhe pranë KLD-së e protokolluar me nr. (***), datë 20.09.2018.

Bazuar në sa më lart, arrihet në përfundimin se rezultati i rivlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Adrian Shega, konsiston në sa vijon:

- i. Në tërësi konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi mesatare profesionale. Kjo për shkak se në drejtim të arsytimit ligjor subjekti i rivlerësimit në disa raste argumenton ligjërisht mendimin e tij dhe propozon zgjidhje konkrete, ndërsa në disa të tjera nuk vepron me të njëjtën mënyrë.

- ii. Gjithashtu, ka raste kur nuk pasqyrohet arsyetim i subjektit në lidhje me shkaqet e rekursit. Kjo nënkupton se subjekti ka munguar që të vepronte ashtu siç duhej, - që në çdo rast në relacionet e veta të argumentonte bazuar në parashikimet ligjore të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar dhe shkronjat “a” ose/dhe “b” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo për shkak se, vetëm duke u analizuar thellësisht shkaqet e rekursit të paraqitur, në koherencë me këto dispozita ligjore, sugjerimet për gjyqtarin/trupën gjykuese do të ishin të argumentuara për shkaqet pse rekursi duhej pranuar dhe kaluar më tej çështja për gjykim apo duhej të ndodhte e kundërta. Analiza ligjore në këtë formë do të shërbente si pikënisje, ndihmëse, për një vendimmarrje të drejtë të bazuar në ligj dhe/ose prova.
- iii. Megjithatë, konstatohet se përgjithësisht relacionet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit pasqyrojnë rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs.

C/2/d - GJETJE TË TJERA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

I - Gjatë hetimit administrativ në dosjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, ndër të tjera është administruar edhe vendimi gjyqësor (civil) nr. 4679, datë **02.06.2011**, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin subjekti i rivlerësimit rezulton me cilësinë e përfaqësuesit ligjor/avokatit (me prokurë të përgjithshme nr (***) rep., nr (***) kol., datë **10.11.2007**) të palës paditëse z. G. D.

- i. Më tej rezulton se vendimi është ankimuar nga pala e paditur, pas së cilës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin, nr. 104, datë 21.01.2013, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
- ii. Komisioni ka hetuar²⁷ lidhur me vijimësinë e këtij procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për shkak të funksionit që subjekti ushtronte në këtë të fundit prej fillimit të vitit 2014.
- iii. Subjekti është pyetur nëse ndaj këtij procesi gjyqësor është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, në cilën fazë është procesi ose nëse ai ka përfunduar, është kërkuar depozitimi i vendimin përkatës.
- iv. Subjekti ka sqaruar²⁸ se: “Shtetasi G. D. është vjehërri i tij dhe se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, nr. 104, datë 21.01.2013, është ushtruar rekurs nga shtetasi A. D. Rekursi është shqyrtuar dhe procesi ka përfunduar në datën 5 qershor 2015”.
- v. Subjekti ka vënë në dispozicion: Vendimin nr. 00-2015 – 1930, datë 05.06.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- vi. Nga verifikimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2015 -1930, datë 05.06.2015²⁹, me të cilin është vendosur: “Mospranim i rekursit të paraqitur nga pala e paditur A. D., kundër vendimit nr.104, datë 21.01.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë”, rezulton se procesi është zhvilluar nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët, M. A., A. Th. dhe Sh. S.

²⁷ Për konflikt interesi të mundshëm.

²⁸ Sipas përgjigjes së subjektit në pyetësonin nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Sipas dokumentit shoqërues të përgjigjes së pyetjes nr. 5 të pyetësonit nr. 2, datë 14.09.2018, në dosjen e Komisionit.

- vii. **Në kushte të tilla vërtetohet se për sa kohë në proces gjyqësor nuk ka qenë pjesë përbërëse gjyqtarja pranë së cilës subjekti ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor edhe ky i fundit nuk rezulton të ketë lidhje me zhvillimin e procesit.**

Për rrjedhojë, Komisioni, konkludon se nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në gjendjen e konfliktit të interesit me detyrën e ushtruar.

II – Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ në korrespondencën e mbajtur me “BKT”-në³⁰, është konstatuar se nga ana e subjektit janë kryer arkëtime përkatësisht, më datat 27.10.2017 dhe 28.12.2017, për llogari të shtetasit E. F., me përshkrim: *“Pagesë për Drejtorinë e Përgjithshme Industriale. Kërkesë për hetim “(***)”, arkëtoi Ardian Shega”*. Për shkak se subjekti ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarës A. F. dhe për shkak se veprimet bankare janë kryer për llogari të një shtetasi me të njëjtin mbiemër më atë të gjyqtarës, është krijuar dyshimi lidhur me këtë marrëdhënie.

- i. Në lidhje me këtë konstatim subjektit i është kërkuar të deklarojë raportin e tij me këtë shtetas.
- ii. Subjekti ka sqaruar³¹ se: *“Shtetasi E. F. është i biri i gjyqtarës A. F., ish anëtare e Gjykatës së Lartë, pranë së cilës unë kam punuar gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies sime të punës, si “Ndihmës ligjor” në Gjykatën e Lartë. Gjatë periudhës tetor 2017 e në vijim kur unë kisha përfunduar detyrën si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë dhe nuk kam pasur asnjë angazhim profesional, në bazë të prokurës së posaçme nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 19.12.2017, notere E. H. T., jam angazhuar për të bërë pagesa në bankë dhe depozitim të dokumenteve pranë QKB-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. **Këto veprime janë kryer nga ana ime pa kundërshtim dhe gjatë një periudhë kohore ku nuk kam pasur angazhime apo detyra të tjera profesionale”**.*
- iii. Subjekti ka vënë në dispozicion:
 1. Prokurë të posaçme, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 19.12.2017.
 2. Fotokopje, faturë për arkëtim, hetim marke (1 fletë).
 3. Fotokopje, shkresë nr (***) prot., datë 03.11.2017, “Njoftim”, e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.
 4. Fotokopje, faturë për arkëtim, kërkesë për regjistrim marke.
 5. Fotokopje, shkresë nr. (***) prot., datë 09.01.2018, “Dëshmi depozitimi” e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.
 6. Fotokopje, kërkesë për regjistrim marke (5 fletë).

Komisioni, konkludon se deklaratimet e subjektit përputhen me aktet e vëna në dispozicion dhe me dokumentacionin e administruar, dhe nuk konstatohen problematika etiko - profesionale lidhur me veprimtarinë e kryer nga subjekti.

³⁰ Sipas përgjigjes së BKT-së, nr. (***) prot., datë 23.07.2018, në dosjen e Komisionit.

³¹ Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 6 të pyetësorit nr. 2, datë 14.09.2018, si dhe dokumenteve shoqëruese, në dosjen e Komisionit

Bazuar në sa më lart, Komisioni, arrin në përfundimin se rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. A. Shega, ka konstatuar sa vijon:

- i. Në tërësi konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi mesatare profesionale. Kjo për shkak se në drejtim të arsytimit ligjor subjekti i rivlerësimit në disa raste argumenton ligjërisht mendimin e tij dhe propozon zgjidhje konkrete, ndërsa në disa të tjera nuk vepron me të njëjtën mënyrë.
- ii. Gjithashtu, kanë rezultuar raste kur nuk është pasqyruar arsyetimi i subjektit në lidhje me shkaqet e rekursit. Kjo nënkupton se subjekti ka munguar që të vepronte në përmbushje të plotë të funksionit të vet, pra që në të gjitha relacionet e veta të kryente argumentime bazuar në parashikimet ligjore të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe shkronjat “a” ose/dhe “b” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo për shkak se, vetëm duke u analizuar thellësisht shkaqet e rekursit të paraqitur, në koherencë me këto dispozita ligjore, sugjerimet për gjyqtarin/trupin gjykues do të ishin të argumentuara për shkaqet pse rekursi duhej pranuar dhe kaluar më tej çështja për gjykim apo duhej të ndodhte e kundërta. Analiza ligjore në këtë formë do të shërbente si pikënisje, ndihmëse, për një vendimmarrje të drejtë të bazuar në ligj dhe/ose prova;
- iii. Megjithatë, konstatohet se përgjithësisht relacionet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit pasqyrojnë rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs.
- iv. Së fundmi, trupi gjykues, mban parasysh faktin që subjekti i rivlerësimit duke qenë aktualisht student i Shkollës së Magjistraturës ka dhe do të ketë mundësinë për të plotësuar mangësitë e konstatuara si dhe për të përmirësuar aftësitë e tij profesionale.

Duke bërë një vlerësim dhe konkluzion të përgjithshëm, trupi gjykues, pasi konstatoi se:

a- në lidhje me rivlerësimin e pasurisë subjekti i rivlerësimit:

- i) Nuk ka kryer deklarime të pamjaftueshme apo të rrem;
- ii) Nuk ka pasur mangësi të burimeve financiare;
- iii) Nuk është konstatuar fshehje pasurie.

b- në lidhje me kontrollin e figurës:

- i. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
- ii. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- iii. Nga rivlerësimi i kryer nga Komisioni, nuk u konstatua asnjë element që mund të çonte në prova apo në dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e mundshme të kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar

apo mbi mangësi në integritetin e subjektit në fjalë.

Për rrjedhojë, trupi gjykues, konkludon se, subjekti Adrian Shega, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

c- në lidhje me vlerësimin e atësive profesionale:

Rezultoi se, pavarësisht mangësive të konstatuara subjektit të rivlerësimit, z. A. Shega, ka aftësi mesatare profesionale dhe ka kaluar me sukses testin profesional të Shkollës së Magjistraturës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega:

- 1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;**
- 2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;**
- 3. ka arritur, të paktën, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.**

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, me funksion këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë të subjekti i rivlerësimit, z. Adrian Shega, me funksion këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016;

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 11.01.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta